



EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

INFORMATIONAL BULLETIN

4 NËNTOR 2014

NJË VËSHTRIM MBI SITUATËN E FUNDIT TË SIGURISË NË KOSOVË

Rreth ECMI Kosovo

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllimin e gjithëmbarshtëm të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe forcon kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të bashkëvepruar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

ECMI Kosova është në dijeni të disa incidenteve që përfshijnë komunitetet pakicë, një pjesë e madhe e të cilëve janë qartazi të motivuara etnikisht. Këto incidente përfshijnë dëmtimin e pronës private si dhe hedhjen e gurëve në shtëpitë e serbëve të Kosovës. ECMI Kosova dëshiron të shfrytëzojë këtë rast që të dënojë këto sulme dhe t'i bëjë thirrje autoriteteve policore që t'i hetojnë këto incidente dhe, sipas nevojës, të kapin autorët e tyre.

Megjithëse situatë e përgjithshme e sigurisë mbetet e qetë dhe stabile, ndërçka politik në Kuvend pesë muaj pas zgjedhjeve ka sjellë një atmosferë ku ekziston një mungesë e perceptuar e autoritetit dhe legjitimitetit në mesin e popullatës, duke krijuar një ndjenjë në rritje të pasigurisë mes popullatës e në veçanti të komuniteteve pakicë. Ndeshja e 14 tetorit e futbollit mes Serbisë dhe Shqipërisë e ndezi situatën edhe më shumë, siç tregohet në raportin tonë *ECMI Kosovo fton për qetësi në përshkallëzimin e tensioneve etnike*.¹ Në vijim është një përmbledhje e shkurtër e disa prej incidenteve që përfshijnë komunitetet pakicë në këto dy javët e fundit.

Incidenti i parë ishin disa grafitë në murin e jashtëm të pronës së manastirit të Kishës Ortodokse Serbe në Deçan që u paraqitën me 12 tetor. Grafitët përmbanin fjalët "ISIS" dhe "UÇK". Ministri i Punëve të Brendshme Rexhepi shpejt lëshoi një deklaratë duke thënë se përgjegjësit për këtë akt janë ndaluar dhe se ata ishin të mitur dhe se nuk ishin pjesë e ndonjë grupi të organizuar ashtu siç ishte cituar të ketë thënë më herët Ati Sava i manastirit.² Mbishkrime të ngjashme "ISIS" dhe "AKSH" (Ushtria Kombëtare Shqiptare) janë raportuar edhe më 30 tetor në afërsi të hidrocentralit në komunën me shumicë serbe në veri të Kosovës Zubin Potokut. Zubin Potoku është një komunë me praninë të pakët të Policisë së Kosovës dhe asnjë i dyshuar nuk është ndaluar deri tani.

Pas këtyre incidenteve, përfaqësuesit e tri bashkësive më të mëdha fetare në Kosovë - Kishës Ortodokse Serbe, Kishës Katolike të Kosovës dhe të Bashkësisë Islame të Kosovës- u takuan në Prishtinë me komandantin e KFOR-it Francesco Paolo Figliuolo, dhe njëzëri denoncuan aktet e fundit të vandalizmit në afërsi të manastirit.³

Sipas raportimeve të disa mediave, duke filluar nga 23 tetori deri më 30 tetor, ndodhën disa incidente të ndryshme nëpër Kosovë duke përfshirë hedhjen e një mjete që duket të ketë qenë një Molotov koktej⁴ si dhe gurë të hedhur në drejtim të shtëpive të të kthyerve serbë në komunën e Fushë Kosovës dhe në rajonet e Klinës⁵ dhe

¹ <http://www.ecmikosovo.org/ep-content/uploads/2014/10/English.pdf>.

² <http://www.shekulli.com.al/ëeb/p.php?id=57822&kat=111>

³ http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2014&mm=10&dd=30&nav_category=640&nav_id=917836

⁴ http://kossev.info/strana/arhiva/%EF%BB%BFna_lokal_u_kosovu_polju_bacen_molotovljev_koktel_/2719

⁵ http://www.danas.rs/danasrs/iz_sata_u_sat/napad_na_srpsku_kucu_u_klini.83.html?neës_id=84663

Istogut.⁶ Ministri për Komuniteteve dhe Kthim Dalibor Jevtić i dënoi këto sulme dhe deklaroi se ai beson që këto ngjarje mund ta rrezikojnë procesin e kthimit, dhe se këto janë pjesë e ngjarjeve pas lojës Serbi – Shqipëri..⁷ Përkundër përpjekjeve disa ditore, ECMI Kosova nuk ka mund të verifikojë këto raporte me Policinë e Kosovës.

Përveç kësaj, shtëpi të pabanuara që i përkasin një familjeje serbe në Gjakovë janë shkatërruar në bazë të një vendimi komunal. Komuna më pas lëshoi një deklaratë ku thuhej se shtëpitë janë rrënuar pas kërkesave të shumta nga qytetarët nga frika për sigurinë e tyre. Kryetarja e Komunës Kusari-Lila dha një intervistë për mediat lokale duke thënë se pronarët dhe institucionet përkatëse janë njoftuar për këto vendime dhe se të gjitha procedurat e duhura ligjore janë respektuar. Familja, pronën e së cilës komuna e rrënoi, dha një deklaratë për media në Serbi duke thënë se ata ishin pronarët e këtyre shtëpive dhe se ata nuk janë njoftuar për ndonjë problem me shtëpitë e as nuk ishin të njoftuar që ato kanë rrezikuar jetën e qytetarëve. Ata presin dëmshpërblim të plotë nga komuna. Ministri për Komuniteteve dhe Kthim Dalibor Jevtić, e dënoi edhe këtë incident duke thënë se ai ka dëshirë t'i ndihmojë serbëve të kthehen në këtë qytet, por se ky qytet “është i ndaluar për serbët.”⁸

Incidentet e fundit nënvizojnë faktin se mbetet shumë për t'u bërë nga autoritetet përkatëse dhe shoqëria civile drejt stabilizimit të mëtejshëm të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë. Incidentet si ato gjatë ndeshjes së futbollit lehtë mund të çojnë në situata të paparashikueshme. Në veçanti, disa nga episodet e fundit kanë nxjerrë në pah edhe një herë fragjilitetin e të kthyerve që jetojnë në vendbanime me shumicë shqiptare si dhe faktin se shumë më shumë mbetet për t'u bërë në procesin e ri-integrimit të këtyre komuniteteve pas kthimit të tyre në Kosovë. E fundit, por jo edhe më pak e rëndësishme, mungesa e perceptuar e autoritetit për shkak të ngërçit të stërzgatur politik ka ndikuar negativisht në marrëdhëniet e brishta etnike në Kosovë.

ECMI Kosova fuqishëm dënon incidentet e fundit dhe u bën thirrje autoriteteve që autorët e tyre t'i sjellin para drejtësisë dhe të sigurojnë mbrojtjen e duhur jo vetëm për të kthyerit në Kosovë por për të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Si një organizatë e angazhuar për çështje të ndjeshme të komunitetit, ECMI Kosova shfrytëzon këtë mundësi për të përsëritur sërish mbështetjen e saj të palëkundur në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë për të gjithë qytetarët e saj, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike apo kulturore.

⁶ <http://www.vesti-online.com/Vesti/Hronika/443172/Napad-na-kucu-Srbina-Imam-problema-sa-novim-Albancima>

⁷ <https://www.kosovalive360.com/sulmet-ndaj-familjeve-serbe-rrezikojne-procesin-e-kthimit.html>

⁸ http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2014&mm=10&dd=30&nav_category=640&nav_id=917740